



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:092161

Datë: 07.04.2021

Numri i dokumentit: 01670539

PKR.nr.1/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje nga Kryetarja e Trupit Gjykues Medie Bytyçi, me Bashkëpunëtorin Profesional Lavdim Mehmeti dhe procesmbajtësen Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të pandehurit T.Z. nga fshati K., Komuna e G., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.884/2012, të datës 29.10.2015, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës, bazuar në nenin 106 të KPRK-së, e më datë 07.04.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.I.nr.884/2012, të datës 29.10.2015.

PUSHOHET procedurën penale kundër të pandehurit T.Z. nga i ati B. dhe nëna H., e vajzërisë A., i lindur me datë .... në fshatin K. , Komuna e G., ku edhe jeton, me nr. personal ....., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Teknologjisë-ing. i Teknologjisë, i punësuar në SHA “....”, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara Shoqëria Aksionare “...”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.884/2012, të datës 29.10.2015 kundër të pandehurit T.Z., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Kryetarja e trupit gjykues pas pranimit të lendeve me datë 15.01.2021 dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret ka arritur afati kohor i ndalesës absolute të ndjekjes penale.

Lidhur me këtë çështje penale kjo Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në referim të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.884/2012, të datës 29.10.2015 dhe me Aktgjykimin PKR.nr.627/2015, të datës 22.07.2019 është liruar nga akuza, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, me arsyetimin se veprimet e të akuzuarit për të cilat është akuzuar nuk përbëjnë veprën penale në fjalë të Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, por të veprës penale Lidhje e kontratës se dëmshme nga neni 237 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet se tani i akuzuari ka kryer veprën penale Lidhje penale Lidhje e kontratës se dëmshme nga neni 237 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.627/2015, të datës 22.07.2019 ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës-

Departamenti për Krime të Rënda, me Aktvendimin PAKR.nr.456/2019, të datës 19.12.2019, e ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë kurse Aktgjykimin PKR.nr.627/2015, të datës 22.07.2019, e ka anuluar dhe çështjen penale e ka kthyer në Gjykatën e shkallës së parë, në rigjykim dhe në rivendosje.

Meqenëse vepra penale është kryer me datën 17.03.2010, për të cilën vepër sipas dispozitës së nenit 422 par.1 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, gjykata pasi shqyrtoi dhe vlerësoj shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret është arritur parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 106 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, vepra penale e cila është e dënueshme me më shumë se tre (3) vite burgim parashkruhet kur të kanë kaluar pesë (5) vite nga data e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), kurse sipas dispozitave të nenit 107 par. 8 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) vite nga koha e kryerjes së veprës penale, ngase vepra penale dyshohet se është kryer me dt:17.03.2010, ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur me dt:16.03.2020.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 3 dhe 106 par.1.5, 107 par. 8 të KPK-së, si dhe nenin 253 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti për Krime të Rënda -  
PKR.nr.1/2020, datë 07.04.2021

Kryetarja e Trupit Gjykses  
Medie Bytyçi

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.